



Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија
Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shkup
26.06.2020

NJOFTIM
për nënshkrimin e eRecetës me çertifikatë të kualifikuar digjitale (token)

Me Ligjin e të Dhënave në Formë Elektronike dhe Nënshkrimin Elektronik, është rregulluar që përgjithësisht nënshkrim i pranuar elektronik është një nënshkrim elektronik nëse: ai është i lidhur ekskluzivisht vetëm me nënshkruesin dhe mund të vërtetohet nga nënshkruesi. Nënshkrim përgjithësisht i pranuar elektronik me çertifikatë të kualifikuar të lëshuar në lidhje me të dhënat elektronike është barazuar me nënshkrimin personal dhe për këtë arsye ka vlefshmëri dhe forcë të provës, si një nënshkrim personal i shkruar me dorë lidhur me dokumentet prej letre.

Për këtë arsye, gjatë përshkrimit të çdo ilaçi veçmas, me recetë në ngarkesë të Fondit, mjeku i zgjedhur duhet të nënshkruajë eRecetën me një çertifikatë të kualifikuar digjitale (token). Vetëm duke përdorur çertifikatën e kualifikuar digjitale gjatë nënshkrimit të recetave të përshkruara nga mjeku i zgjedhur, vlefshmëria ligjore e recetave elektronike do të aktivizohet.

Mjekët e përzgjedhur tashmë kanë siguruar çertifikatën e kualifikuar digjitale (token) me të cilën nënshkruajnë në mënyrë elektronike formularët ZM për zgjedhjen e mjekut dhe shërbimeve të tjera elektronike të ofruara nga Fondi. Kjo do të thotë që me të njëjtën çertifikatë të kualifikuar digjitale, do të jenë në gjendje të nënshkruajnë ilaçet e përshkruara në eRecetë.

Njëkohësisht, theksojmë se prezentimi i vulës elektronike dhe lidhja e nënshkrimit elektronik me kohën e përshkrimit të ilaçit të eRecetës do të kalojë përmes sistemit të Fondit. Prandaj, mjekët e zgjedhur nuk kanë nevojë të furnizohen me vulë elektronike.

Mënyra e nënshkrimit elektronik dhe verifikimi me vulë elektronike të institucionit shëndetësor të eRecetës do të përshkruhet në detaje në Udhëzimin Teknik.